



e Rahovecit

Mbështetje për bujqit – nis shpërndarja e plehut artificial

Ka nisur shpërndarja e plehut artificial 15•15•15 + 18SO₃ për 1,130 bujq përfitues që kanë plotësuar kriteret e përcaktuara. Shpërndarja po realizohet në dy faza: në fazën e parë po shpërndahen 4,500 thasë për 450 bujq, ndërsa në fazën e dytë do të shpërndahen edhe 5,500 thasë për 680 bujq të tjerë.

Komuna mbulon 80% të kostos së plehut, ndërsa 20% mbulohet nga vetë bujqit.



5 Maji – Dita e Dëshmorëve të Kombit

Me rastin e 5 Majit – Ditës së Dëshmorëve të Kombit, kryetari Latifi, së bashku me familjarë të dëshmorëve, përfaqësues të OVL-UÇK-së dhe qytetarë, bëri homazhe në nderim të heronjve dhe dëshmorëve të atdheut. Duke kujtuar sakrificën e tyre për liri, ai theksoi rëndësinë e ruajtjes dhe promovimit të vlerave për të cilat ata dhanë jetën.



U përmbyll me sukses edicioni jubilar i Festivalit “Anadrinia jehon”

Pas tri netëve radhazi me aktivitete kulturore e artistike, u përmbyll me sukses edicioni i 25-të i Festivalit të Folklorit “Anadrinia Jehon”, një nga ngjarjet më të rëndësishme në promovimin e kulturës dhe folklorit shqiptar.

Me pjesëmarrjen e 17 grupeve artistike nga vise të ndryshme shqiptare, festivali solli para publikut interpretime të pasura folklorike dhe vlera autentike kombëtare. Çmimin e parë e fitoi Ansambli i Këngëve dhe Valleve “Gurra” nga Kurbin, vendin e dytë Ansambli “Kastriotët” nga Ferizaji, ndërsa vendin e tretë Ansambli “Bajram Curri” nga Prishtina. Edicioni jubilar dëshmoi edhe një herë traditën, vlerën dhe jehonën që ka ndërtuar ky festival ndër vite.

